



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 1934/prot.

13

Pogradec, më 22, 05, 2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

" PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR SHESH PËR DEPOZITIMIN E PËRKOHSHËM TË MATERIALEVE TË NDRYSHME (PIKA TRANSITI), TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 40000 M2 (DYZET MIJË) M2."

Me respekt,

KRYETARI
Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (Dy)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 4(Kater)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KESHILLI

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ 2025

PROJEKT-VENDIM
Nr. ____, DATË ____/____/2025

PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR SHESH PËR DEPOZITIMIN E PËRKOHSHËM TË MATERIALEVE TË NDRYSHME (PIKA TRANSITI), TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 40000 M2 (DYZET MIJË) M2.

Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedurës dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.816, datë 04.06.2008 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore pyje e kullota në Komunën Çërravë, të Qarkut të Korçës", i ndryshuar me VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, date 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish – Komunave /Bashkive", si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave, Nr.559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytëzim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", me propozim të Kryetarit të Bashkisë,, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim dhënien me qira, per shesh për depozitimin e përkohshëm të materialeve të ndryshme (pika transiti), për pasurinë e ndodhur në fshatin Blacë, Njësia Administrative Çërravë, Bashkia Pogradec, me të dhënat si më poshtë:

Nr	Z.K	Pasuria	Vëndodhja	Siperf në m2	Objekti kerkeses
1	1208	34/1	Blacë, Çërravë	40000	Shesh për depozitimin e përkohshëm të materialeve të ndryshme (pika transiti)

2. Afati i dhenies me qera te jete deri ne 10 vite, me te drejte ripertëritje, sipas periudhes te percaktuar ne projektin teknik, të hartuar nga kërkuesit në konkurim.
3. Ne referim te bazes ligjore te sipercituar, ky proces te kryhet sipas percaktimeve te Pikes 5, shkronja "dh", Kreu I, Pikes 6, shkronja "b", germa "i" , Kreu II, të Vendimit Nr. 54, datë

05.02.2014 të Keshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

4. Tarifat për dhënie me qira të kësaj pasuri, të aplikohen sipas pikes "12", të shtojcës nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 të Keshillit të Ministrave "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në Shfrytëzim/ përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.
5. Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Pogradec për ndjekjen e procedurave ligjore dhe për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TOKES BUIQESORE NE NJESITE ADMINISTRATIVE
SEKTORI TRAJTIMIT TITUJVE PRONESISE DHE SHPRONESIMEVE

Nr. 1944 / Prot.

Pogradec, më 21.05.2025

RELACION

PËR

**MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE
INDIVIDEVE KËRKUES PËR SHESH PËR DEPOZITIMIN E
PËRKOHSHEM TË MATERIALEVE TË NDRYSHME (PIKA TRANSITI),
TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 40000 M2 (DYZET MIJË) M2.**

I NDERUAR KRYETARE KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Bashkia Pogradec në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, referuar pikës 2 të nenit 27 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ndër të cilat është edhe Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme, pyll,etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, posacerisht të kaluara në pronësi të saj me VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, date 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish – Komunave /Bashkive", Me transferimin e pronave në administrimin vendor, menaxhimi i aseteve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin.

Për sa më sipër, Sektori i Trajtimit të Titujve të Pronësisë dhe Shpronësimeve, Bashkia Pogradec, ka marrë evidentuar pronen me nr 34 Zk 1208 qe mund te jete nje prone qe mund te zhvillohet nga individe te ndryshem per qellimin e cituar me lart, për vete pozicionimin dhe vendosjen e kesaj prone mabsi eshte larg nga qendrat e banuar dhe pa ndikime ne mjedis.

Nga analiza dhe interesimi i disa individeve dhe pozicjonin e pasurise propozojme dhenien me qera te siperfaqes prej 4 ha siperfaqe e cila sipas llojit te qeverisjes se pyjeve sipas planit te mbareshtimit te ish komunes Cerrave eshte inproduktive ne vendin e quajtur Blace si dhe nga verifikimi ne vend dolen me keto konkluzione:

Sipas VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, date 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish – Komunave /Bashkive", pasuria 34 Zona kadastrale 1208 i kalon ne pronesi Bashkise Pogradec., e cila duke ndjekur te gjitha procedurat ligjore eshte paisur me dokumentacionin perkates te pronesise, bashkangjitur ketij relacioni.

Per sa me siper, u monitorua pasuria nr. 34 toke inproduktive pyll qe kerkohet te miratohet ne parim fillimi i procedurave per dhenie me qira, me siperfaqe 40000 m2, me të dhënat si më poshtëme;

Nr	Z.K	Nr Pasur	Vëndodhja	Lloji Pasurisë	Sipr në m2	Perdorimi sipas plan biznesit	Fakti ne momentin e monitorimit
1	1208	34	Lumi çerrave.	Inprodukti ve, pyll	40000	Shesh për depozitim e përkohshëm të materialeve të ndryshme (pika transiti)	Inprodukti ve, Pyll 

Sipërfaqia e kerkuar ndodhet , ne kufirin ndermjet Fshatrave Cerrave dhe Blace ne nje largesi te konsiderueshme nga qendrat e banuara, dhe tradicionalisht ka qene pjese e fshatit Çërravë pavaresisht se ne zone kadastrale eshte ne fshatin Blacë

Ne referim te bazes ligjore te sipercituar, ky proces te kryhet sipas percaktimeve te Pikes 5, shkronja "dh", Kreu I, Pikes 6, shkronja "b", germa "i" , Kreu II, të Vendimit Nr. 54, datë 05.02.2014 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e kriterëve, te procedurës dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar.

Tarifat për dhënien në përdorim/qera të ketyre pasurive, të aplikohen sipas pikes "12", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien ne Shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.

Gjithashtu, kontrata bashkengjitur projekt vendimit, eshte hartuar ne zbatim te Vendimit Nr. 421, datë 12.6.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

Perfundimisht, per sa me sipër, Në zbatim të nenit 54, shkronja "e" të Ligjit Nr. 139, datë 17.12 2014 "Për veteqeverisjen vendore", citohet se: *"Këshilli bashkiak, ndër të tjera, e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve". Mbasi edhe konsultimi publik me pjesëmarrjen e keshilltareve eshte realizuar.*

Duke pasur besim te plote, ju ftojme te miratoni projekt vendimin e paraqitur.
Ju Faleminderit !

Ju faleminderit!

Konceptoi: Nexhmi TORRA

Konfirmoi Paskalino ZIKO

Miratoi Dritan BABASULLI

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS



ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
BASHKIA POGRADEC	K44802605R	1/1

Numri i Pasurisë	34/1		
Kodi Unik	1208012180		
Zona Kadastrale	1208		
Lloji i Pasurisë	PYLL		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 40000	Truall: 0	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë	1		
Adresa e Pasurisë			

DREJTORI
Zhuljen Manellari

Franci Beshiraj
Eugen Alinj

Data e lëshimit: 23/12/2024
Manellari



Vleruar elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Pogradece
Data: 2024/12/23 15:53:34 +0200
K44802605R/2024/122315532704L/014



Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe nënshkruar elektronikisht nga sistemi automatizuar i Agjencisë Shtetërore e Kadastrës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS



FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 1208

KODI UNIK: 1208012180

NUMRI PASURISË: 34/1

INDEKSI HARTËS: K-34-114-(121-A)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 2500

DREJTORI

Zhuljen Manellari

Eugen

Alin

Digitally signed by:
Eugen Alin

Date: 2024.12.24
08:01:48 +02'00'

Franci

Besmir

Digitally signed by:
Franci Besmir

Date: 2024.12.24
08:09:03 +02'00'

Zhuljen

Manellari

Digitally signed by:
Zhuljen Manellari

Date: 2024.12.24
08:14:03 +02'00'



Vlerësoi elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Pogradec
Data: 2024/12/24 08:01:48 +02'00'
K64982605R202412240801356024014

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe verifikuar me një
si një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

SHPJEGUES

- ☐ PARCELA
☒ NDËRTESA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 1208012180
(Nga 1208002052, Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 1208, Lloji i Pasurisë: PYLL, Nr. i Pasurisë: 34/1, Sipërfaqja Totale 40000 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-114-(121-A), Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K -1, Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 0343, Dt. 23/12/2024), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B - TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: BASHKIA POGRADEÇ, Nr. Identifikimi/NIPT K44802605R, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i
Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga DESHMORET E POJSKES, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____,
Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Regjistrim i bashkimit, ose ndarjes të pasurisë së
paluajtshme, Nr. 0343, Datë: 23/12/2024

Regjistruar: Nr. 0343, Datë: 23/12/2024

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 - TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____